



Në bazë të Programit për financimin e projekteve për zhvillimin e artizanatit, hotelërisë dhe tregtisë së Qytetit të Shkupit për vitin 2022 (Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit numër 2/22), Qyteti i Shkupit shpall

Thirrje publike
për alokimin e mjeteve për financimin e projektit për zhvillimin e artizanatit,
hotelërisë, tregtisë dhe turizmit, manifestimeve nga fusha e artizanatit,
hotelërisë dhe tregtisë me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2022

I

Thirrja publike shpallet për realizimin e manifestimit të mëposhtëm:

1. “Skopje Park fair”

II

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë të gjitha shoqatat civile, fondacionet, federatat, institucionet, shoqatat tregtare dhe agjencitë e marketingut.

III

Në suazat e Thirrjes publike do të mbështetet nga ana financiare projekt i cili do të kontribuojë për realizimin e manifestimeve nga kreu I si dhe për zhvillimin në fushat e mëposhtme:

- zhvillimi dhe promovimi i artizanatit në Qytetin e Shkupit,
- zhvillimi dhe promovimi i hotelërisë në Qytetin e Shkupit,
- zhvillimi dhe promovimi i tregtisë në Qytetin e Shkupit,
- zhvillimi dhe promovimi i turizmit në Qytetin e Shkupit,
- aktivitete për avancimin e hotelërisë dhe tregtisë në Qytetin e Shkupit dhe
- projekte që janë me rëndësi të jashtëzakonshme për Qytetin e Shkupit.

IV

Korniza kohore dhe mënyra e alokimit të mjeteve

Mjetet janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2022 në Programin për financimin e projekteve për zhvillimin e artizanatit, hotelërisë dhe tregtisë së Qytetit të Shkupit për vitin 2022, nënprogrami G1, zëri 426. Shfrytëzimi i mjeteve të alokuara do të rregullohet me lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe aplikuesit, i cili plotëson kriteret në përputhje me Thirrjen publike.

V

Kritere themelore organizative

Kriteret themelore organizative që duhet t'i plotësojnë aplikuesit e interesuar që marrin pjesë në këtë Thirrje publike janë:

- Të jenë regjistruar në Regjistrin Qendror me seli në Shkup;
- të kenë shlyer obligimet ndaj Qytetit të Shkupit (tatim, taksa komunale) dhe
- të mos kenë ndalim për pjesëmarrje në procedurat e thirrjeve publike, dhënien e kontratave për prokurim publik dhe kontratave për partneritet publik privat

VI

Kritere themelore për përzgjedhjen e aplikuesve janë:

Kritere	Pikë maksimale
1. Struktura organizative dhe burime	30
1.1 Përvoja e aplikuesit në zbatimin dhe realizimin e manifestimeve	10
1.2 A ka aplikuesi strukturën e nevojshme organizative dhe burimet njerëzore për zbatimin e projektit (punonjës, vullnetarë aktivë, persona të angazhuar me honorar, etj.)	10
1.3 Dukshmëria e aplikuesit online	10
2. Financimi i projekteve	30
2.1 Plan financiar i detajuar për mjetet e nevojshme për realizimin e manifestimit	10
2.2 A siguron aplikuesi përqindje të pjesëmarrjes së tij në realizimin e projektit	10
2.3 A është plani financiar i propozuar real (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive të pozicioneve korrespondon me çmimet e tregut)	10
3. Cilësia e projektit	40
3.1 Sa do të kontribuojë qëllimi i përgjithshëm i projektit në realizimin e prioriteteve të dhëna, sa është i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate	10
3.2 Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara në projekt-propozim	10
3.3 Përfshirje e siguruar e institucioneve dhe organizatave të tjera	10
3.4 A është plani i zbatimit të projektit i qartë dhe i arritshëm	10

*Çdo fushë e kriterëve të veçanta do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me këtë kuptim: 1-jo, 5-pjesërisht dhe 10-po.

VII

Vlerësimi i cilësisë së projekteve

Vlerësimi i cilësisë së projekteve të aplikuesve të interesuar të cilët plotësojnë kriteret themelore organizative, do të kryhet në bazë të kriterëve të theksuara në kreun VI. Vlerësimin e projekt-propozimit më të mirë të do ta kryejë Komisioni i formuar nga kryetarja e Qytetit të Shkupit.

VIII

Dokumentacioni i nevojshëm, të cilin aplikuesi duhet ta depozitojë të bashkëngjitur me Aplikimin

Përveç aplikimit i cili duhet të plotësohet (në mënyrë digjitale me shkronja shtypi dhe në alfabetin cirilik), të jetë nënshkruar nga person kompetent dhe vërtetuar me vulën e shoqatës, fondacionit, shoqatës tregtare, institucionit apo agjencisë së marketingut, aplikuesi detyrimisht duhet të depozitojë bashkëngjitjet e mëposhtme:

- Gjendje aktuale nga Regjistri Qendror ose Aktvendim për regjistrimin e shoqatës apo fondacionit;
- Deklaratë e nënshkruar për detyrime të shlyera ndaj Qytetit të Shkupit (tatim, taksë komunale);
- Vërtetim se nuk ka ndalim për pjesëmarrje në procedura për thirrje publike, ndarjen e kontratave për furnizime publike dhe kontrata për partneritet publik-privat (Regjistri Qendror);
- Propozim projekt i plotësuar në mënyrë digjitale me shkronja shtypi dhe në alfabetin cirilik;
- Plan financiar i plotësuar në mënyrë digjitale me shkronja shtypi dhe në alfabetin cirilik.

IX

Dokumentacioni shoqërues

Aplikuesit të bashkëngjitur duhet të depozitojnë edhe dokumentacionin shoqërues të mëposhtëm:

- biografi profesionale e ekspertëve të cilët do të angazhohen në realizimin e projektit,
- listë referuese,
- të paktën dy mendime/referenca nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme
- përkrahje me shkrim nga organizata ose institucione të tjera për të cilat është planifikuar të marrin pjesë në realizimin e projektit dhe
- plani i marketingut të manifestimit.

X

Mënyra e zbatimit të Thirrjes publike

Për zbatimin e Thirrjes publike kryetarja e Qytetit të Shkupit me Aktvendim formon Komision. Komisioni është i obliguar që të shqyrtojë projekt-propozimet e depozituara, të bëjë vlerësimin e projekteve në bazë të kriterëve të përcaktuara me Thirrjen Publike dhe të depozitojë pranë kryetares së Qytetit të Shkupit propozim për lidhjen e marrëveshjes me aplikuesin projekti i të cilit është vlerësuar me më shumë pikë.

Vërejtje: Aplikimet me dokumentacion të pakompletuar ose që do të depozitohen pas afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Bashkëngjitjet e depozituara nuk kthehen.

XI

Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 5 ditë nga dita e shpalljes së Thirrjes Publike.

Aplikimi me dokumentacionin e plotë duhet të depozitohet në zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** (me shënimin - Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik - Aplikim për Thirrje publike)

Aplikuesit për Thirrjen publike do të njoftohen për rezultatet në një afat kohor prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të Thirrjes publike.

Aplikimi për mbështetje financiare, kriteret për përzgjedhje dhe konstruksioni financiar janë në dispozicion në ambientet e Qytetit të Shkupit, Sektori për Zhvillim Lokal Ekonomik, baraka nr. 6, zyra nr. 5 çdo ditë pune nga ora 9.00 deri në orën 16.00.

Pyetje për sqarime plotësuese mund të parashtrohen me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë Sektorit për Zhvillim Lokal Ekonomik.
Kontakt tel: (02)3297-372 dhe adresa e-mail: [Biljana.Stojmanovska@skopje.gov.mk](mailto: Biljana.Stojmanovska@skopje.gov.mk)

XII

Periudha e realizimit të projekteve

Periudha e realizimit të plotë të projektit është deri më 15 dhjetor 2022, ndërsa brenda 7 ditëve nga dita e realizimit të projektit pranë Qytetit të Shkupit duhet të depozitohet raport programor, raport narrativ i përfunduar dhe dokumentacion i plotë financiar për realizimin e projektit me specifikim për shpenzimet e përgjithshme dhe kopje nga dokumentacioni i plotë financiar.

QYTETI I SHKUPIT